

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

THIRRJE PËR APLIKIM PROJEKTESH II PËR VITIN 2023

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në zbatim të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shpall këtë Thirrje për Aplikime Projektesh për vitin 2023, për institucione dhe organizata, të cilat punojnë dhe kontribuojnë në fushën e medias.

Subjektet e interesuara (më poshtë subjekti aplikues), ftohen që brenda **datës 15.05.2023, ora 12:00** të paraqesin dorazi, në zyrën e protokollit të AMAs, të gjithë dokumentacionin e propozimit për projektin me temë: “Televizioni në rrjetet sociale”.

1. Komponenti: Televizioni linear në rrjetet sociale

Qëllimi i projektit: Qëllimi kryesor i projektit do të jetë një studim i thelluar mbi rolin dhe impaktin e televizionit në rrjetet sociale, duke u fokusuar tek monitorimi i këtij fenomeni në realitetin shqiptar, duke e krahasuar atë me praktikën mediatike në vendet perëndimore, mbi bazën e një reflektimi teorik të mbështetur në literaturën më të përparuar në tregun e ideve dhe të kërkimit shkencor.

Televizioni dixhital shfaqet sot në peizazhin e mediave audiovizive në një numër platformash. Ndër to, janë edhe rrjetet sociale. Në këtë mënyrë kjo medie audiovizive merr një formë dhe përmbajtje të re duke integruar rrjetet sociale me televizionin dhe na dhënë kështu një realitet të ri mediatik sikurse është televizioni i mediave sociale (social media television). Televizioni linear në rrjetet sociale po njihet një evoluim shumë të shpejtë kudo në botë, por që përbën një risi që operatorët televizivë në Shqipëri, të cilët ende rezistojnë për arsye të ndryshme, ta përqafojnë.

Aspekte thelbësore të projektit do të jenë analiza e sjelljes të re të audiencave konsumatore të këtij televizionit duke na dhënë atë që quhet bashkë-menaxhim i televizionit (kompani – audienca), si dhe sfidat kryesore etike në përmbajtjet audiovizive që shpërndahen përmes platformave në rrjetet sociale.

Produktet që duhet të realizojnë subjektet aplikuese:

- Një studim të thelluar mbi rolin dhe impaktin e televizionit në rrjetet sociale, duke u fokusuar tek monitorimi i këtij fenomeni në realitetin shqiptar, duke e krahasuar atë me praktikën mediatike në vendet perëndimore, mbi bazën e një reflektimi teorik të mbështetur në literaturën më të përparuar në tregun e ideve dhe të kërkimit shkencor. Pjesë e studimit do të jetë dhe një analizë e sjelljes të re të audiencave konsumatore të këtij televizionit, duke na dhënë atë që quhet bashkë-menaxhim i televizionit (kompani – audienca).
- Organizimi i një konference shkencore që do të ketë në fokus gjetjet e studimit, por dhe krijimin e një hapësire të lirë të shkëmbimit të pikëpamjeve të ekspertëve të fushës, por dhe grupeve të interesit.
- Organizimi i të paktën tre seancave të leksioneve të hapura nga ekspertë të ftuar me gazetarë të rinj e studentë të gazetarisë dhe komunikimit, mbi sfidat kryesore etike në përmbajtjet audiovizive që shpërndahen përmes platformave në rrjetet sociale.
- Botim me ISBN i studimit të thelluar si dhe aspekte kryesore të prezantimit dhe diskutimit në konferencën shkencore.

Fondi limit në dispozicion nga AMA për këtë komponent është në masën 3,500,000 lekë.

2. Komponenti: “Transmetimet Audiovizive dhe Inteligjenca Artificiale”

Qëllimi i projektit: Inteligjencën artificiale (AI), edhe pse përcaktohet si lëmi i shkencave kompjuterike, gjithmonë e më tepër po e hasim në të gjitha sferat e jetës. Zhvillimi teknologjik i inteligjencës artificiale, vec të tjerash, mundëson gjetjen dhe përmirëson shpërndarjen e informacionit. Nën dritën e kësaj dinamike, zhvillimet teknologjike po orientojnë edhe strukturën përmbajtësore në fushën e medias.

Pa dyshim përfitimi i përmirësimit të motorit të kërkimit nëpërmjet algoritmeve është i madh dhe shërben në rritjen e efikasitetit në proceset e punës dhe veprimtarinë në media, por ai gjithashtu, mund të ketë edhe pasoja të mundshme negative, duke sjellë monitorim, manipulim, censurë, çrregullim informacioni, propagandë etj., duke u përpjekur të formësojë ide e opinione. Pra, IA është një faktor kyç që përcakton nivelin e besimit në media dhe shkallën në të cilën media mund të manipulohet nga, reklamuesit, qeveritë apo palët e treta. Këto algoritma krijojnë dhe mbrojnë nga Fake News.

Duke pasur parasysh vakumin në literaturë për informacione dhe koncepte mbi këtë çështje, propozohet realizimi i një studimi analitik mbi ndikimin e zhvillimeve teknologjike dhe inteligjencës artificiale në transmetimet audiovizive.

Një studim i tillë cilësor, do të shërbejë si referencë dhe si manual në funksion të gazetarëve, redaktorëve, menaxherëve të medias, studentëve, pedagogëve e studiuesve të fushës së shkencave të komunikimit.

Produktet që duhet të realizojnë subjektet aplikuese:

- Një studim mbi transmetimet audiovizive dhe inteligjencën artificiale.
- Aktivitete/ tryeza pune, në të paktën 6 qytete të vendit, ku do të parashtrihen gjetjet e këtij studimi analitik dhe do të diskutohen ide dhe pikëpamje që lidhen me të.
- Botimi me ISBN, ku do të përfshihen studimi analitik dhe dinamika e takimeve në qytete.

Fondi limit në dispozicion nga AMA për këtë komponent është në masën 1,500,000 lekë

3. Komponenti: “Roli dhe ndikimi i medias audiovizive në mbrojtje të shëndetit mendor”

Qëllimi i projektit: Media audiovizive mund të ndikojnë fuqishëm në mënyrën se si ne e shohim botën. Media mund të ketë ndikim pozitiv, por edhe pasoja të mundshme negative në zhvillimin dhe shëndetin mendor të audiencës. Në kohën e sotme informacioni na serviret nga media në mënyra të ndryshme. Gazetarët gjithnjë të tërhequr nga lajmet e bujshme nuk portretizojnë domosdoshmërisht situatën reale që përshkruajnë, duke manipuluar e formësuar kështu opinione. Duke qenë të ekspozuar ndaj fenomenit gjithmonë e në rritje të gjuhës së urrejtjes, seksizmit, scoop-et e korinakve të zeza, ekspozimi i fëmijëve ndaj përmbajeve të dëmshme mediatike audiovizive, shpesh shihen si të pandjeshme ndaj interesit publik dhe ndikimit të kësaj përmbajtje tek konsumatori.

Duke pasur parasysh edhe periudhën e COVID-19, në kontekstin e distancimit social, u rrit ndjeshëm konsumimi i përmbajtjeve mediatike. Prandaj do të ishte me shume vlerë një studim mbi ndikimin e këtij të fundit në cilësinë e jetës dhe mirëqenies sociale e mendore.

Produktet që duhet të realizojnë subjektet aplikuese:

- Një studim analitik mbi trajtimin e shëndetit mendor në transmetimet audiovizive.
- Aktivitete/ tryeza pune në të paktën 5 qytete të vendit, ku do të diskutohen ide dhe pikëpamje në lidhje me trajtimin e shëndetit mendor në transmetimet audiovizive.
- Botimi me ISBN, ku do të përfshihet studimi analitik dhe dinamika e takimeve.

Fondi limit në dispozicion nga AMA për këtë komponent është në masën 1,500,000 lekë

4. Komponenti: “Roli dhe ndikimi i medias audiovizive në efektivitetin e zbatimit të rregullave të qarkullimit rrugor dhe reduktimi e aksidenteve”

Qëllimi i projektit: Roli i medias është fundamental ne edukimin, informimin, argëtimin dhe sensibilizimin e opinionit publik.

Trajtimi i rasteve të aksidenteve rrugore është i përditshëm në media, përfshirë dhe median audiovizive. Kronika informative, materiale analitike, intervista apo formate të tjera pasqyrimi në edicionet e lajmeve apo emisione tematike janë pjesë e përmbajtjeve të transmetuara.

Media audiovizive ka rol informues mbi aksidentet rrugore, por dhe trajtimin e çështjeve që parandalojnë apo edukojnë drejtuesit e automjeteve dhe qytetarët në përgjithësi, ndaj dhe është shumë e rëndësishme që dhe radaksitë të përfshihen në kualifikime mbi këtë temë.

Produktet që duhet të realizojnë subjektet aplikuese:

- Një studim analitik mbi mbulimin që media audiovizive i bën trajtimit të rasteve të aksidenteve rrugore.
- Aktivitete, tryeza pune në të paktën 6 qytete të vendit, ku do të parashtrihen gjetjet e studimit analitik dhe të diskutohen ide dhe pikëpamje në lidhje me fenomenin.
- Botimi me ISBN, ku do të pëfshihet studimi analitik dhe dinamika e takimeve në qytete.

Fondi limit në dispozicion nga AMA për këtë komponent është në masën 1,500,000 lekë

1. PROCESI APLIKUES

Aplikimi, veç Formularit të Aplikimit (teksti i së cilës gjendet më poshtë), të plotësuar në të gjitha rubrikat, duhet të përmbajë detyrimisht:

1.1 Ekstraktin e Gjykatës (i cili merret në Zyrën e Regjistrimit të OJF-ve, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë) - origjinal ose kopje e noterizuar e lëshuar brenda 3- muhorit, referuar datës së mbylljes së afatit të aplikimit. (Nëse subjekti aplikues është person juridik publik, përjashtohet nga detyrimi i përmbushjes të kësaj pike)

1.2 Dokumenti i regjistrimit në organin tatimor (NIPT).

1.3 Vërtetim që organizata është me status aktiv në momentin e aplikimit.

1.4 Vërtetim që nuk ka detyrime të pashlyera: të detyrimeve tatimore dhe të sigurimeve shoqërore, deri në fund të muajit janar 2023, të lëshuara nga administrata tatimore.

1.5 Një informacion të hollësishëm të aktivitetit dhe kontributit të subjektit aplikues në fushën e medias.

1.6 CV-të për gjithë anëtarët e grupit të punës që planifikohet të angazhohen me projektin, në mënyrë të veçantë ekspertët.

1.7 Vërtetim për numër llogarie bankare, në lekë.

1.8 Kalendari i aktiviteteve që subjekti aplikues parashikon të realizojë nga fillimi deri në përfundim të projektit, i plotësuar sipas aneksit “Skeda informative e projektit”, pjesë e kësaj Thirrjeje.

1.9 Deklaratë nga subjekti aplikues për respektimin e të drejtave të autorit.

Dokumentacioni i aplikimit duhet të jetë i nënshkruar nga subjekti aplikues.

2. KËRKESA TË TJERA PËR APLIKUESIN

2.1 Aplikanti duhet të shprehet që në fillim të aplikimit në mënyrë të drejtpërdrejtë se ka interes për projektin, duke e cituar atë sipas formulimit të kësaj Thirrjeje.

2.2 Subjekti aplikues duhet të konceptojë dhe planifikojë finalizimin e të gjitha produkteve dhe aktiviteteve, si dhe dorëzimin e të gjithë dosjes së dokumentacionit narrativ, të kontratave, dhe atë justifikues për shpenzimet e kryera, brenda afatit 10-mujor nga data e nënshkrimit të kontratës. Data e finalizimit duhet të pasqyrohet në “Skeda informative e projektit”, sipas pikës 1.8 të Thirrjes.

2.3 Në planin buxhetor të projektit të propozuar, vetë subjekti aplikues, detyrimisht duhet të ketë të pasqyruar një angazhim vetëfinancues jo më pak se 25% të vlerës totale të buxhetit.

Aplikimet e dorëzuara në protokollin e AMA-s, përtej datës dhe orës së përcaktuar si afat përfundimtar në këtë thirrje data 15.05.2023, ora 12:00, nuk do të merren në shqyrtim. AMA do të vijojë komunikimin dhe

procedimin e mëtejshëm vetëm me subjektet aplikues, të cilëve iu vlerësohet aplikimi në përputhje me kërkesat e kësaj thirrje.

Në faqen zyrtare të AMA-s, gjeni udhëzimin “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për thirrjet për aplikim të projekt-propozimeve në fushën e mediave audiovizive”.

[http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Udhezim-per-aplikim-projekte-“Per\[1\]percaktimin-e-rregullave-dhe-procedurave-per-thirrjet-per-aplikim-te-projekt-propozimeve\[1\]ne-fushen-e-mediave-audiovizive”.pdf](http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Udhezim-per-aplikim-projekte-“Per[1]percaktimin-e-rregullave-dhe-procedurave-per-thirrjet-per-aplikim-te-projekt-propozimeve[1]ne-fushen-e-mediave-audiovizive”.pdf)

Autoriteti i Mediave Audiovizive

Tiranë më, 11.04.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**THIRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIME
NË FUSHËN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE
FORMULAR PËR APLIKIM PËR FONDE MBËSHTETJE**

PJESA I: INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Titulli i projektit: [Type text]

Aplikanti (*emri i organizatës që aplikon/partneri 1*): [Type text]

Statusi ligjor i organizatës që aplikon: [Type text]

Numri i regjistrimit të organizatës që aplikon: [Type text]

Vendi i regjistrimit të organizatës që aplikon: [Type text]

Data e regjistrimit të organizatës që aplikon: [Type text]

Adresa: [Type text]

Faqja në internet: [Type text]

Personi i kontaktit: [Type text]

Pozita në organizatë: [Type text]

Tel: [Type text]

E-mail: [Type text]

Kohëzgjatja e projektit: nga data/muaj/vit [Type text] deri në datën/muaj/vit [Type text]

Vendi ose vendet e realizimit të projektit: [Type text]

Fusha dhe tema e projektit: [Type text]

Buxheti total: [Type text]

Fondet e kërkuara nga AMA: [Type text]

Informacion për bashkëfinancim (emri-shuma): [Type text]

Partnerët e Projektit: [Type text]

PJESA II: PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Qëllimi i projektit: Përshkruani shkurtimisht projektin, problematikën që ai adreson, si dhe argumentimin se si projekti u përgjigjet nevojave të identifikuara (*maksimumi 10 rreshta*).

[Type text]

Objektivat e projektit (*maksimumi 5 rreshta për secilin objektiv*):

1. [Type text]

2. [Type text]

3. [Type text]

4. [Type text]

5. [Type text]

Lloji i aktiviteteve sipas fushës, p.sh. studime tregu, rritje e zhvillim audiencash, aktivitete trajnuese, hulumtime..ejt, si dhe një përshkrim më i detajuar i aktiviteteve që janë planifikuar në çdo fushë (*maksimumi 5 rreshta për secilin aktivitet*):

1. [Type text]

2. [Type text]

3. [Type text]

4. [Type text]

5. [Type text]

A janë aktivitetet e propozuara të përshtatshme, praktike dhe në përputhshmëri me objektivat dhe rezultatet e pritura? (*Maksimumi 5 rreshta*):

[Type text]

A përmban projekti tregues objektivisht të verifikueshëm lidhur me rezultatet e aktiviteteve? (*Maksimumi 3 rreshta për secilin aktivitet*):

Aktiviteti 1:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Type text]

Aktiviteti 2:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Type text]

Aktiviteti 3:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Type text]

Aktiviteti 4:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Type text]

Aktiviteti 5:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Type text]

Cili është grupi ose cilat janë grupet e synuara? (Lutemi të përshkruani shkurtimisht, në mënyrë sa më të përmbledhur, se cili është grupi parësor i synimit të projektit dhe se si kanë për t'i shërbyer aktivitetet e projektit.)

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Qëndrueshmëria e projektit – impakti afatgjatë i projektit nga pikëpamja e problematikës së adresuar, fushës së zhvillimit të projektit, si dhe organizatës që e propozon.

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Në konceptimin, hartimin dhe zbatimin e projektit, a është respektuar e drejta e autorit? Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

PJESA III: PARTNERËT (NËSE KA)

Bashkërendimi i punës midis partnerëve. (Përshkruani natyrën e partneritetit. Shpjegoni bashkërendimin e punës midis partnerëve duke përshkruar procesin e vendimmarrjes, si dhe funksionin dhe përgjegjësitë e secilit partner në zbatimin e projektit.)

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Partneri 1 (Aplikanti)

Misioni. Cili është misioni i organizatës tuaj?

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Struktura. Përshkruani strukturën e organizatës duke përfshirë detaje, si numrin e të punësuarve dhe strukturën e menaxhimit.

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Financimi. Si financohet organizata juaj dhe cili ishte buxheti i saj për vitin paraardhës?

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Partneri 2

Emri organizatës: [Type text]

Personi i kontaktit: [Type text]

E-mail: [Type text]

Adresa: [Type text]

Faqja në internet: [Type text]

Partneri 3

Emri i individit/organizatës: [Type text]

Personi i kontaktit: [Type text]

E-mail: [Type text]

Adresa: [Type text]

Faqja në internet: [Type text]

PJESA IV: BUXHETI

Lutemi të përshkruani shpenzimet e përfshira për implementimin e projektit. Çfarë burimesh të fondeve të tjera janë të siguruar dhe të mundshme?

Plotëso: Tabelën për kostot financiare pjesë e kësaj Thirrjeje.

TABELA E KOSTOVE FINANCIARE

Emri i subjektit aplikues:

Titulli i Projektit:

Koha e zbatimit: nga/deri

Nr.	Lloji i shpenzimit	Njësia	Sasia	Çmimi në lekë	TOTAL	AMA	Vetë aplikanti	Donatorët e tjerë -I-	Donatorët e tjerë -II-
SHPENZIMET SIPAS AKTIVITETEVE DHE ZËRAVE PËRKATËS									
1	AKTIVITETI 1: Titulli...								
1.1									
1.2									
1.3									
	TOTAL AKTIVITET _ 1			-	-				
2	AKTIVITETI 2: Titulli....								
2.1									
2.2									
2.3									
	TOTAL AKTIVITET _ 2			-	-				
3	AKTIVITETI 3: Titulli....								
3.1									
3.2									
3.3									
	TOTAL AKTIVITET _ 3			-	-				

4	AKTIVITETI 4: Titulli ...								
4.1									
4.2									
4.3									
	TOTAL AKTIVITET _ 4			-	-				
	TOTALI I SHPENZIMEVE (1+2+3+4+..) lekë								
	TOTALI I SHPENZIMEVE (1+2+3+4+..) %								

Sqarim:

- Ju lutemi, të llogaritni shumën totale që mbulon çdo donator (duke përfshirë AMA-n dhe vetë subjektin aplikues), edhe si % e buxhetit total për projektin.

SKEDA INFORMATIVE E PROJEKTIT

Emri i subjektit aplikues:

Titulli i projektit:

Aktiviteti <i>(Përshkrimi)</i>	Qyteti	Periudha	Fusha/Gjinia	Nr. audiencës <i>(parashikim)</i>	Nr. personave të angazhuar <i>(Pagesa honorar)</i>	Partneri zbatues

Shënim:

- Ju lutem, shënoni **Aktivitetin** me të gjitha të dhënat që kërkohen.